



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2287/2 prot.,

Datë 15.08.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK & “MF INVEST GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, me REF-07624-05-31-2024, me objekt “Mbeshtetje Per Programin 2024 – 2026 – “Shërbime Projektimi”, i ndarë në Katër Lote, **Loti 2: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, publike dhe/ose kulturore, mbi tokë dhe nën tokë”, me nr. REF- 07630-05-31-2024**, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 820,452.22 Euro, zhvilluar më datë 10.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK me NIPT 11807013M (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK.

Adresa: Rruga Dritan Hoxha, Nd. 117, Shk.2, Ap.4/2 Tiranë-Albania, Kodi postar 1023, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

Me datë 14.08.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar dorazi ankesa me Nr.2287/2024 Prot., datë 14.08.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “CEC

GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, me REF-07624-05-31-2024, me objekt “Mbeshtetje Per Programin 2024 – 2026 – “Shërbime Projektimi”, i ndarë në Katër Lote, **Loti 2: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, publike dhe/ose kulturore, mbi tokë dhe nën tokë”**, me nr. **REF- 07630-05-31-2024**, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 820,452.22 Euro, zhvilluar më datë 10.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit..

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar:”*

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Bashkimi i operatoreve “CEC Group” & “MF Invest Group” pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se nuk plotësohet kriteri 2.2 i kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumenteve Standarde të Tenderit si vijon: Kriteri 2.2: Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit – 83,333,333.00 leke pa TVSH). Sipas dokumenteve të paraqitura “CEC Group ” nuk e përmbush kriterin ekonomik pasi vlera më e madhe e xhiros vjetore të deklaruar për tre vitet e fundit është më e vogël se përqindja e marrë përsipër. Në bazë të përqindjes së marrë përsipër në këtë bashkim operatorësh, xhiroja vjetore duhet të ishte 66,666,666.40 lekë, ndërkohë që është paraqitur një vlerë më e vogël dhe për rrjedhojë bashkimi i operatorëve nuk plotëson kriterin e vendosur për xhiron vjetore. Sjellim në vëmendje Ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik: Referuar ndryshimeve të fundit në ligjin nr. 16/2024, neni 17 parashikon shfuqizimin e nenit 50 “Shërbim konsulence”. Kjo sjell në vëmendje parashikimet e nenit 88, pika 3, ku parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.” Sa më sipër, në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe referuar ndryshimeve ligjore të

sipërpërmendura, bashkimi i operatorëve “CEC Group” & “MF Invest Group” nuk plotëson kriterin 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Për këtë arsye, skualifikohet”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 15.08.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri